

TREMA TECH SH.P.K.

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 20

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015**

	Shënime	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	24,464	255,668
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	8,123,813	9,074,916
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	2,769,389	3,471,661
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	1,582,310	1,988,975
Inventari	8	2,341,082	2,677,751
Shpenzime të shtyra	9	11,850	-
Total Aktive Afatshkurtra		14,852,908	17,468,971
Aktivët afatgjata			
Aktive financiare		100,000	100,000
Aktive afatgjata materiale	10	670,612	840,572
Total aktive afatgjata		770,612	940,572
Total Aktive		15,623,520	18,409,543
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	11	1,336	-
Llogari të pagueshme tregtare	12	8,135,507	9,731,738
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	13	-	1,272,290
Detyrime tatimore	14	216,402	315,681
Të ardhurat e shtyra	15	83,468	83,468
Provizione		-	-
Të tjera detyrime	16	3,029,184	3,312,902
Total Detyrime afatshkurtra		11,465,897	14,716,079
Detyrime afatgjata			
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	17	9,555,574	9,876,217
Total Detyrime afatgjata		9,555,574	9,876,217
Totali i detyrimeve		21,021,471	24,592,296
Kapitali aksionar	18		
Kapitali i nënshkruar		12,000,000	12,000,000
Rezerva ligjore		136,866	136,866
Rezerva të tjera		(18,319,618)	(17,196,650)
Fitimi i ushtrimit		784,801	(1,122,969)
Total kapitali aksionar		(5,397,951)	(6,182,753)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		15,623,520	18,409,543

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Tëardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	19	13,729,936	6,385,186
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	20	(90,995)	44,289
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(12,096,301)	(5,509,100)
Lënda e parë dhe materiale të			
1 konsumueshme	21	(11,709,612)	(4,989,891)
2 Të tjera shpenzime	22	(386,689))	(519,209)
Shpenzime të personelit	23	(726,454)	(1,815,911)
1 Paga dhe shpërblime		(652,500)	(1,654,500)
Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore (paraqitur			
2 veçmas nga shpenzimet për pension)		(73,954)	(161,411)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(169,960)	(213,218)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	24	(137,302)	(18,514)
Të ardhura të tjera		-	-
Shpenzime financiare	25	275,877	4,299
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike			
1 brenda grupit)		(19)	(2,149)
2 Shpenzime të tjera financiare		275,896	6,448
Pjesë e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
Fitimi/humbja para tatimit		784,801	(1,122,969)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	26	-	-
Fitimi/humbja e vitit		784,801	(1,122,969)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		784,801	(1,122,969)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Trema Tech sh.p.k.
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2013	12,000,000	136,866	100,460	(17,297,110)	(5,059,784)	(5,059,784)
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël						
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2014						
Fitimi / Humbja e vitit				(1,122,969)	(1,122,969)	(1,122,969)
Lëvizjet përmes kapitalit			(17,297,110)	17,297,110	-	-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2014	12,000,000	136,866	(17,196,650)	(1,122,969)	(6,182,753)	(6,182,753)
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2015						
Fitimi / Humbja e vitit				784,802	784,802	784,802
Lëvizjet përmes kapitalit			(1,122,969)	1,122,969	-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	12,000,000	136,866	(18,319,619)	784,802	(5,397,951)	(5,397,951)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori i Trema Tech Sh.p.k. më 26/03/2016 dhe janë firmosur si më poshtë.

Mazars Sh.p.k.
MAZARS
Hartuesi i Pasqyrave Financiare
Rr. Emin Durrësi, Pall "Bijakët",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al , info@ mazars.al


Genc Sokolaj
Administrator
Adr: Rr. Durrësit, Sheshi "Karl Topia"
Tirane - Albania

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	784,801	(1,122,969)
Shpenzimet financiare jomonetare	(166,322)	6,296
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	169,960	213,218
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	2,048,191	3,960,665
Rënie/(rritje) në inventarë	336,669	908,881
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(2,955,742)	(3,508,730)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(295,776)	(220,226)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(78,219)	237,135
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara	1,336	
Pagesa e huave	(44,758)	
Interes i paguar		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(43,422)	
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(121,641)	237,135
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	255,668	31,268
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(109,563)	(12,735)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 24,464	255,668

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

"Trema Tech" sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në datën 09.01.2008, në përputhje me Ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë tregtare".

Shoqëria është e regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore me NiptK81309063C.Selia e shoqërisë është në: Rruga e Durrësit, sheshi Karl Topia, pll.127, kati 1, Tiranë, Shqipëri.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 100 aksione me vlerë nominale 120,000 Lekë për një vlerë totale 12,000,000 Lekë.

Trema Tech Sh.p.k është një shoqëri shqiptare, e krijuar nga ortakët:

- Z.Illir Trebicka, që zotëron 80% të kapitalit të shoqërisë;
- Z.Genc Sokolaj që zotëron 20% të kapitalit të shoqërisë.

Administrator i shoqërisë është Z. Genc Sokolaj.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është shitje, blerje, import-eksport të gjeneratorëve, kompresorëve dhe pjesëve të tyre të këmbimit.

Në 31 dhjetor 2015 shoqëria ka 1 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e

drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2015	2014
Euro/LEK	137.28	140.14
USD/ LEK	125.79	115.23
GBP/LEK	186.59	179.48

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto

të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje dhe Orendi	Vlerae mbetur	20 %
Automjete	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlerae mbetur	25 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Mjete monetare në bankë	8,883	167,866
Llogari rrjedhëse	8,883	167,866
Mjete monetare në arkë	15,581	87,802
	24,464	255,668

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Klientë	8,123,813	9,074,916
	8,123,813	9,074,916

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë të arkëtueshme nga palët e lidhuramë 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Kërkesa të arkëtueshme	1,058,077	
Kërkesa tregtare të arkëtueshme	1,711,312	3,471,661
	2,769,389	3,471,661

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Tatim mbi fitimin	1,548,310	1,548,310
TVSH e kreditueshme		400,364
Detyrime doganore		6,301
Të tjera kërkesa të arkëtueshme	34,000	34,000
	1,582,310	1,988,975

8. Inventari

Inventarët më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Lëndë e parë dhe materiale	337,676	325,339
Mallra për rishitje	2,003,406	2,352,412
	2,341,082	2,677,751

9. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Shpenzime të periudhave të ardhshme	11,850	-
	11,850	-

(Vlerat janë në Lek)

10. Aktive Afatgjata Materiale

	Makineri Pajisje	Automjetet	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Te tjera	Totali
<i>Kosto</i>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	36,500	2,236,667	178,000	181,617	494,194	3,126,978
Shtesa						0
Pakësime						0
Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	36,500	2,236,667	178,000	181,617	494,194	3,126,978
Shtesa						0
Pakësime						0
Gjëndja më 31 Dhjetor 2015	36,500	2,236,667	178,000	181,617	494,194	3,126,978
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	(24,998)	(1,552,617)	(117,024)	(132,392)	(246,157)	(2,073,188)
Amortizimi i vitit	(2,300)	(136,810)	(12,195)	(12,306)	(49,607)	(213,218)
Pakësime						0
Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	(27,298)	(1,689,427)	(129,219)	(144,698)	(295,764)	(2,286,406)
Amortizimi i vitit	(1,840)	(109,448)	(9,756)	(9,230)	(39,686)	(169,960)
Pakësime						0
Gjëndja më 31 Dhjetor 2015	(29,138)	(1,798,875)	(138,975)	(153,928)	(335,450)	(2,456,366)
<i>Vlera neto kontabël</i>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	11,502	684,050	60,976	49,225	248,037	1,053,790
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	9,202	547,240	48,781	36,919	198,430	840,572
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	7,362	437,792	39,025	27,689	158,744	670,612

11. Hua Afatshkurtra

Huat afatshkurtra më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Overdraft	1,336	-
	1,336	

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Furnitorë vendas	4,958,340	5,653,426
Furnitorë të huaj	3,177,167	4,064,542
Furnitorë për fatura të pambërritura	-	13,770
	8,135,507	9,731,738

13. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura paraqesin detyrimet më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Llogari të pagueshme		704,384
Llogari të pagueshme		567,906
	-	1,272,290

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	-	61,188
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	-	38,096
Tatim në burim	216,402	216,397
	216,402	315,681

15. Të ardhura të shtyra

Të ardhurat e shtyra paraqiten më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Parapagim nga klientë	83,468	83,468
	83,468	83,468

16. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Detyrime ndaj personelit	3,017,070	3,312,846
Shteti TVSH	7,515	-
Të tjera detyrime	4,599	56
	3,029,184	3,312,902

17. Detyrime afatgjata ndaj palëve të lidhura

Detyrimet afatgjata ndaj palëve të lidhura paraqiten më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Financim Ilir Trebicka	8,276,127	8,674,911
Financim Genc Sokolaj	1,279,447	1,201,306
	9,555,574	9,876,217

18. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i shoqërise është 12,000,000 LEK i zotëruar 80% nga Z. Ilir Trebicka dhe 20% nga Z. Genc Sokolaj.

	31 Dhjetor 2015 në Lek	31 Dhjetor 2014 në Lek
Numri i aksioneve	100	100
Vlera nominale (në LEK)	120,000	120,000
Kapitali i nënshkruar	12,000,000	12,000,000

Shoqëria ka humbje të mbartura më 31 dhjetor 2015 në vlerën 18,420,077 LEK.

19. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga shitja e mallrave	375,220	1,347,845
Të ardhura nga shërbimet	13,354,716	5,037,341
	13,729,936	6,385,186

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Shitje total të deklaruara në FDP TVSH	13,734,087
Shitje të deklaruara në FDP që janë të ardhura në PASH	13,734,087
Shitje mallrash	375,220
Shërbime	4,151
Të tjera	13,354,716
Të ardhura të deklaruara në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	13,734,087
Fitim nga këmbimet valutore	623,946
Total të ardhura të deklaruara FDP e Tatim Ftimit	14,358,033

20. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Fitime nga këmbimet valutore	221,412	64,836
Humbje nga këmbimet valutore	(316,557)	(20,547)
Të ardhura të tjera	4,150	-
	(90,995)	44,289

21. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Kosto e materialeve të para	236,972	613,701
Dieta	94,033	60,000
Shpenzime për komunikim	127,137	190,961
Transport	45,000	53,215
Kosto e mallrave të shitura	10,916,130	3,981,855
Nënkotaktorë	133,445	-
Mirëmbajtje dhe riparime makineritë dhe fabrika	107,400	56,680
Prime sigurimi	11,850	-
Energji elektrike, ujë	37,645	33,479
	11,709,612	4,989,891

22. Te tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë përvitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime për licence software, konfigurim, setup	31,387	7,928
Shpenzime administrative dhe noteriale	1,100	8,600
Konsulenca ekonomike dhe juridike	192,265	329,487
Blerje të ndryshme, kancelari etj	-	833
Komisione bankare	42,876	70,841
Taksa të ndryshme	43,667	45,856
Shpenzime të ndryshme dhe të panjohura	75,394	55,664
	386,689	519,209

23. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime për paga	652,500	1,654,500
Shpenzime për sigurime shoq. e shëndetësore	73,954	161,411
	726,454	1,815,911

Numri i punonjesve më 31 dhjetor 2015 është 1 (2014:4).

24. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjokat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Gjoka dhe penalitete	137,302	18,514
	137,302	18,514

25. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime për interesa	(19)	(2,149)
Te ardhura nga interesat	11	9
Humbje nga këmbimet valutote	(126,639)	(2,134)

Te ardhura nga kembimet valutore	402,524	8,573
	275,877	4,299

26. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Fitimi para tatimit	784,801	(1,122,969)
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	244,083	679,982
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	168,689	62,343
Shpenzime të tjera	75,394	617,639
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	1,028,884	(1,122,969)
Humbje fiskale e mbartur	(1,028,884)	
Tatim fitimi @15%	784,801	(1,122,969)

Shoqëria ka humbje tatimore të mbartura si paraqiten më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Humbje fiskale 2013 (skadojnë në 2016)	5,462,950	5,462,950
Humbje fiskale 2014 (skadojnë në 2017)	1,075,836	1,075,836
	6,538,786	6,538,786

Humbjet tatimore mund të mbarten deri në 3 vjet.

Nuk janë njohur aktive për tatime të shtyra në lidhje me këto zëra pasi nuk ka siguri se fitimi i ardhshëm i tatueshëm do të jetë i mjaftueshëm për të kompensuar humbjet tatimore të mbartura.

27. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Bilanci kontabël		
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
Ilir Trebicka	8,276,125	8,674,911
Genc Sokolaj	1,279,449	1,201,306
T & C Sh.p.k.		704,384
Trema Engineering 2		567,906
	9,555,574	11,148,507

Të arkëtueshme nga palët e lidhura

T & C Sh.p.k.	1,058,077	-
Trema Engineering 2	1,711,312	3,393,659
		78,002
	2,769,389	3,471,661

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve		
Shitje palëve të lidhura :		
Trema Engineering 2	2,498,870	1,666,292
	2,498,870	1,666,292
Blerje nga palët e lidhura:		
Trema Engineering 2	-	5,580
	-	5,580

28. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2014 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkoje rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë te besueshme

29. Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyrafinanciare.